



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.139/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e mediave vendore “Radio KIM”, “R Media L.L.C”, “TV Gračanica D.O.O”, “Raporto24.com”, “Radio KM”, “TV MOST D.O.O”, “Kontakt Kosovska Mitrovica”, “Alternativna”, “RTV Puls D.O.O”, “Vendi Sot”, “Gračanicaonline.info”, paraqitur kundër Vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 09.10.2025, nga Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, me të cilin është refuzuar kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 11.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHEN ANKESAT e mediave vendore me numra: ZL.Anr.139/2025 “Radio KIM”; ZL.Anr.174/2025 “R Media L.L.C”, ZL.Anr.176/2025 “TV Gračanica D.O.O”, ZL.Anr.177/2025 “Raporto24.com”, ZL.Anr.178/2025 “Radio KM”, ZL.Anr.179/2025 “TV MOST D.O.O”, ZL.Anr.180/2025 “Kontakt Kosovska Mitrovica”, ZL.Anr.181/2025 “Alternativna”, ZL.Anr.182/2025 “RTV Puls D.O.O”, ZL.Anr.183/2025 “Vendi Sot”, ZL.Anr.184/2025 “Gračanicaonline.info”, të paraqitura kundër Vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 09.10.2025, në mungesë të interesi juridik.

A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhje me datë 09.10.2025 ka miratuar listën për akreditimin e 703 mediave vendore. Me rastin e votimit njëzet e nënë (29) prej mediave ndërkombëtare dhe vendore nuk kanë marrë votat e nevojshme për akreditim nga anëtarët e KQZ-së.

Me datë 10.10.2025 mediat vendore “Radio KIM”, “R Media L.L.C”, “TV Gračanica D.O.O”, “Raporto24.com”, “Radio KM”, “TV MOST D.O.O”, “Kontakt Kosovska Mitrovica”, “Alternativna”, “RTV Puls D.O.O”, “Vendi Sot”, “Gračanicaonline.info”, kanë parashtruar ankesë kundër vendimeve të KQZ-së të datës 09.10.2025 përmes të cilëve janë refuzuar akreditimet e mediave vendore të lartcekura.

Në përgjigje në kërkesë KQZ me datë 11.10.2025 ka deklaruar se pas mbledhjes së KQZ-së e cila është mbajtur me datë 10.10.2025, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) ka rekomanduar rivlerësimin e dokumentacioneve të aplikimeve të mediave për akreditim. Pas vlerësimit të dokumentacioneve të dorëzuara me rastin e aplikimit të informatave në dispozicionet nga burimet: Këshilli i Pavarur për Media dhe Këshilli i Mediave të Shkruara në Kosovë, Zyra ka paraqitur rekomandim për KQZ për akreditimin e mediave vendore, “Radio KIM”, “R Media L.L.C”, “TV Gračanica D.O.O”, “Raporto24.com”, “Radio KM”, “TV MOST D.O.O”, “Kontakt Kosovska Mitrovica”, “Alternativna”, “RTV Puls D.O.O”, “Vendi Sot”, “Gračanicaonline.info”, KQZ pas këtij rekomandimi me datë 10.10.2025 ka mbajtur mbledhje po atë ditë përmes të cilës kanë akredituar mediat e lartcekura.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendorsjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar 11 ankesat e datës 10.10.2025, të paraqitura me numrat si më lartë dhe të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.139/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht ankesat dhe përgjigjen në ankesë, gjeti se:

Parashtruesve të ankesës i mungon interesi juridik.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 09.10.2025 ka mbajtur mbledhje dhe ka refuzuar akreditimin e mediave vendore për shkak dyshimeve rreth vërtetësisë dhe legjitimitetit të dokumentacioneve. Me datë 10.10.2025 mediat vendore kanë parashtruar ankesë ndaj vendimit të KQZ-së të datës 09.10.2025.

Me rastin e shqyrtimit të ankesave PZAP iu ka drejtuar KQZ-së për të dhënë përgjigje në raport me ankesat e mediave të paraqitura për mos akreditim si vëzhgues për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datën 12 Tetor.

KQZ me anë të përgjigjes në ankesë ka konfirmuar se me vendimin e datës 10.10.2025 pas rivlerësimit të dokumentacioneve të aplikimeve të mediave për akreditim, të njëjtat i ka akredituar, meqenëse të njëjtat i plotësojnë kushtet ligjore.

PZAP duke vlerësuar ankesat e mediave në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtave i mungon interesi juridik për parashtrimin e ankesës meqenëse të njëjtat janë akredituar.

Me dispozitën e nenit 119 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është paraparë që: “Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe

PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”. Në rastin konkret meqenëse, mediat vendore të cilat kanë parashtruar ankesë, tani më janë akredituar, sipas vendimeve të KQZ-së,

Andaj PZAP-i, vlerëson se, ankesat e parashtruar janë pa interes juridik pasi mediat vendore, “Radio KIM”, “R Media L.L.C”, “TV Gračanica D.O.O”, “Raporto24.com”, “Radio KM”, “TV MOST D.O.O”, “Kontakt Kosovska Mitrovica”, “Alternativa”, “RTV Puls D.O.O”, “Vendi Sot”, “Gračanicaonline.info”, janë akredituar nga KQZ me datë 10.10.2025.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë bazë dhe nga arsyet e sipërsënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.139/2025 më datën 11.10.2025.

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetë e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.